

VENDIMET E MBLEDHJES SË BORDIT 22 TETOR 2021

Vendimi Nr. 2021-052

Kursi Teknik për Trajner të Tenisit 2022

- Bordi me shumicë votash miratoi propozimin për organizimin e një kursi teknik për trajner në mars 2022, pas thirrjes së pranuar nga Akademia Olimpike.
- Aplikimi për organizimin e këtij kursi do të dërgohet për aprovim në Akademinë Olimpikë të Kosovës të cilët njëheri në bashkëpunim me Solidaritetin Olimpik do të jenë edhe financues të aktivitetit.

Vendimi Nr. 2021-053

Ceremonia e Laureatëve 2021

- Bordi me shumicë votash aprovoi datën për organizimin e Ceremonisë së Laureatëve 2021.
- Ceremonia e Laureatëve 2021 do të mbahet më datë 19 Dhjetor 2021.
- Detajet tjera do të prezantohen javëve në vijim.

Vendimi Nr. 2021-054

Hartimi i strategjisë për organizimin e garave ROG

- Bordi merr vendim për hartimin e një strategjie për organizimin më të mirë të turneve ROG. Kjo strategji do të hartohet nga një grup punues prej 3 anëtarësh i cili do të propozohet dhe votohet në mënyrë elektronike në bord.

Vendimi Nr. 2021-055

Kategorizimi i Klubeve 2022

- Bordi me shumicë votash merr vendim të aplikohet kategorizimi i klubeve.
- Kriteret e kategorizimi të klubeve do të hartohen nga një grup punues i cili do të votohet nga bordi drejtues, më së largu deri më 31 dhjetor 2021.

Vendimi Nr. 2021-056
Beach Tennis

- Bordi me shumicë votash aprovoi propozimin e Kryetarit Hadërgjonaj për fillimin e disiplinës beach tennis.
- FTK në 2022 do të fillojë me një aktivitet të beach tennis, i cili do të realizohet në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Tenisit.

Vendimi Nr. 2021-057
Kërkesat e Klubeve

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimin që kërkesat e klubeve të kalojnë në federatë përmes anëtarit të bordit Lorik Haxhishabani.
- Të gjitha kërkesat e klubeve duhet të dërgohen në mënyrë elektronike tek anëtari i bordit Lorik Haxhishabani në emailin lorikhaxhishabani07@gmail.com, i cili më pas do ti adresojë ato në federatë.

Vendimi Nr. 2021-058
Programet Intensive 2021

- Bordi me shumicë votash merr vendim që programet intensive të rifillojnë në nëntor 2021, kësaj radhe me 2 programe 1. Kategoria U16/U18 dhe 2. Kategoria U12/U14.
- Programi intensiv për këto kategori do të zgjasë për 5 muaj, ndërsa detajet tjera për trajnerët e involvuar, lokacionet, oraret do të votohen online ditëve në vijim.

Vendimi Nr. 2021-059
Sezoni Dimëror për klubet

- Bordi me shumicë votash merr vendim që FTK edhe në 2021 të ndihmojë klubet financiarisht në sezonin dimëror.
- Thirrja për mbështetjet në sezonin dimëror 2021 do të u dërgohet klubeve posa të definohen kushtet për këtë vit.

Vendimi Nr. 2021-060

Vendosja e balonit tek fushat e KT Rilindja

- Bordi me shumicë votash merr vendim që baloni (donacion) nga Turqia të vendoset në fushat e tenisit të KT Rilindja.
- Baloni është pronë e FTK, ndërsa kushtet për shfrytëzimin e tij do të vendosen nga administrata e FTK të cilat do të votohen në bord.

Vendimi Nr. 2021-061

Ndryshimi i emrit të federatës në ueb faqen zyrtare

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimin që emri i ueb faqes të FTK të ndryshohet nga tenniskosova në KosovoTennisFederation.